



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 11 Maj 2021

Nr: 356

**VENDIM**

**Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj z. Amando Hasa, Shef Sektori tek Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

**Kërkues:** Lëvizja Socialiste për Integrim

**Ndaj:** Z. Amando Hasa, Shef Sektori tek Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

**Baza ligjore:** Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 44, 77 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencie dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

**VËREN:**

**I**

**Vlerësimi paraprak**



Data: 11 Maj 2021  
Nr. 356

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj z. Amando Hasa, Shef Sektori tek Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar një denoncim në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluar”, në rubrikën “Kallëzo”, nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim për një veprimtari të z. Amando Hasa, e cila bie në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020.

Kallëzimi i paraqitur nga kallëzuesi ruhet në sistem elektronik dhe identifikohet me numër unik të gjeneruar nga sistemi. Në denoncimin e raportuar më datë 24.04.2021 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 3317, ora 5:51, në ndërfaqen e KQZ-së pretendohet se: *“Më datë 13.04.2021, kandidatja për deputete e Partisë Socialiste Ermonela Valikaj ka postuar në faqen e saj zyrtare Facebook një aktivitet me karakter publik ku pjesëmarrës ka qënë dhe Shefi i Sektorit të Monitorimit të Kontratave Koncesionare në drejtorinë e Monitorimit të Heceve Amando Hasa. Pjesëmarrja e tij është në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.”*

Bashkangjitur këtij denoncimi është dërguar si mjet provues link-u i facebook që vërteton pjesëmarrjen e z. Amando Hasa në këtë aktivitet të zj. Ermonela Valikaj.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues Lëvizja Socialiste për Integrim përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

Referuar nenit 7, të ligjit 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.



Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon të vijojë procedurën administrative ndaj z. Amando Hasa ndaj të cilit atribuohen veprimtari administrative, që vijnë në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr. 9/ 2020, të Komisionit Rregullator në KQZ.

## II.

### Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ me datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datë 26.12.2020. Gjithë të interesuarit mund të disponojnë përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së, në rubrikën “Vendime” dhe kategorinë “Vendime të Rregullatorit” duke filluar nga kjo datë.

Në denoncimin e raportuar pretendohet se z. Amando Hasa me detyrë Shef Sektori, Sektori i Monitorimit të Kontratave Koncesionare, Drejtoria e Monitorimit të Hidrocentraleve, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, në kundërshtim me vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ, ka marrë pjesë në fushatën elektorale të zj. Ermonela Valikaj.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 4918 prot., datë 05.05.2021, i ka kërkuar z. Amando Hasa informacion sqarues në lidhje me pjesëmarrjen e tij në këtë aktivitet të karakterit publik.

Me shkresën e datës 10.05.2021, protokolluar pranë KQZ-së me shkresën nr. 4918/1 prot., datë 10.05.2021, z. Amando Hasa ka dhënë pretendimet e tij duke sqaruar se “*Aktiviteti objekt denoncimi është kryer në datën 13.04.2021 në orën 18:17, në Njësinë 12, rrugë “Muhamet Deliu”, Bar “Deus” pranë degës së Thesarit, kompleks i pallateve ku ai është banor*”.

## III.

### Analiza ligjore

Në nenin 91 pika 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor parashikohet se “*Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit*



administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. “Burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, **si dhe çdo burim njerëzor i institucionit.** Referuar pikës 2, të nenit 3, të vendimit nr. 9/2021 të Komisionit Rregullator në KQZ, “Kryeministri, administrata e tij, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë zëvendësit dhe administrata e tij, Prefekti dhe administrata e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose Ministrit, drejtori i përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive, drejtuesit dhe anëtarët e organeve kolegjiale, enteve, bordeve, çdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti si edhe në çdo ent ku shteti zoteron aksione e kapitale/kuota apo emeron shumicën e organit mbikqyrës ose të organit administrues, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”

Në denoncimin e mësipërm, se z. Amando Hasa mban detyrën e Shefit të Sektorit, Sektori i Monitorimit të Kontratave Koncesionare, Drejtoria e Monitorimit të Hidrocentraleve, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe futet në kategorinë e subjekteve, që gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, **të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi.**

Sipas denoncimit, z. Amando Hasa ka qënë pjesë e një aktiviteti fushate të zj. Ermonela Velikaj, në datën 13.04.2021 ora 18:17. Për këtë arsye, referuar dhe nenit 6, pika 4, të vendimit nr. 9/2021 ku përcaktohet se "Punonjësi i administratës shtetërore, vetëm pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore, ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson së pjesëmarrja e z. Amando Hasa në aktivitetin me pjesëmarrës deputetin dhe kandidatin për deputet zj. Ermonela Velikaj, nuk bie në kundërshtim me dispozitat e vendimit nr. 9/2021, të Komisionit Rregullator në KQZ, pasi është kryer **jashtë orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore.**

Nga provat e vëna në dispozicion nga denoncuesi të administruara gjatë hetimit administrativ, nuk u provua se pjesëmarrja e z. Amando Hasa, në aktivitetin me pjesëmarrës deputetin dhe kandidatin për deputet zj. Ermonela Velikaj, ka qënë brenda orarit zyrtar të punës. Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, denoncuesi në provat që ka dorëzuar nuk provoi që pjesëmarrja ka qënë brenda orarit zyrtar si dhe në mjediset e institucioneve shtetërore. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të



vazhdojë shqyrtimin administrativ për kallëzimin e kryer nga Lëvizja Socialiste për Integrim, pasi në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se, veprimtaria e z. Amando Hasa, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në vendimin nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n”, pika 2, dhe nenet 91, 92, 171/1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 3 pika 2 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dhe nenet 17,18,19 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative

### **V E N D O S:**

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj z. Amando Hasa, pasi nuk konstatohen shkelje të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Illirjan CELIBASHI**

